



AUTOR
RENIS META

DHUNA ME BAZË GJINORE, E PA RAPORTUAR APO E NEGLIZHUAR NGA INSTITUCIONET?

**RAPORT
MONITORIMI**
Prill 2022

QENDRESA
QYTETARE



NED NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Hyrje: Një panoramë e përgjithshme - Dhuna me bazë gjinore në Shqipëri

“Në Shqipëri, si edhe në vende të tjera, nocione të tilla si tradita shumë shpesh mund të shërbejnë si pretekst për aktet e dhunës ndaj grave, të cilat akuzohen se kanë shkelur kode tradicionale të sjelljes, megjithëse ato mund t’u jenë përmbajtur më së miri roleve të tyre ...”

(Amnesty International, 2006, f.4)¹

“Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave” e përkufizon dhunën ndaj grave si “çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose ka gjasa të sjellë lëndime, vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, përfshirë edhe kanosjet për akte të tilla, shtrëngime apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”. Dhuna ndaj grave dhe vajzave është një shkelje e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut (CEDAW)², me pasojat më të rënda që bien mbi viktimat. Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) është një fenomen që prek thellësisht “shëndetin” e shoqërisë në secilën qelizë të saj, me ndikimin më të thellë në jetën e viktimave.

Përballja me dhunën në kultura dhe shoqëri të ndryshme, si dhe të kuptuarit e fenomenit brenda një shoqërie të caktuar dhe angazhimi për t’u përballur me të, është e rëndësishme për zhvillimin e nismave parandaluese, reformave legjislativë dhe hartimin e politikave, si dhe zhvillimin dhe mbështetjen e ndërhyrjeve në sistemet e mbrojtjes dhe përkrahjes për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

Sipas Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (VKDhNGV) të kryer nga INSTAT në vitin 2018, më shumë se gjysma e grave dhe vajzave të moshës 15-74 vjeç në Shqipëri, kanë përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e dhunës gjatë jetës së tyre (dhunë

¹ Amnesty International. (2006). Shqipëria - Dhuna kundër grave në familje: “Nuk është turpi i saj”. Faqe 16

² UN Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women (CEDAW)

nga partneri intim, dhunë në lidhje dashurie, dhunë nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe/ose përndjekja).

Po ashtu, një e treta e grave dhe vajzave, rreth 36.6%, kishin përjetuar dhunë gjatë 12 muajve të fundit kur është kryer anketimi. Sipas gjetjeve të vrojtimit, lloji më i zakonshëm i dhunës është dhuna në lidhje dashurie; lloji i dytë më i zakonshëm i dhunës është dhuna nga partneri intim dhe e treta është ngacmimi seksual. Përveç kësaj, 3.1% e vajzave dhe grave kishin përjetuar abuzim seksual në fëmijëri përpara moshës 18 vjeçare (INSTAT, 2019).³

Në të njëjtën linjë, studimi i ndërmarrë nga OSBE për Mirëqënien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri konstatoi se 19.0% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç kishin përjetuar dhunë nga partneri intim që në moshën 15 vjeçare dhe 19.0% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeç.⁴

Referuar INSTAT (2021), në vitin 2020 janë numëruar 17.829 persona të dëmtuar nga veprat penale, prej të cilëve 4.546 janë gra, rreth 25.5 % e totalit. Të mitur të dëmtuar nga veprat penale kanë qenë 1.035 ose 5.8 % e totalit; 270 janë vajza dhe 765 janë djem të dëmtuar, ku vajzat e dëmtuara nga krimet seksuale përbëjnë 20.7 % (INSTAT, 2021, f.91).⁵

Dhuna ndaj vajzave dhe grave vazhdon të jetë një realitet i vrazhdë dhe shqetësues në Shqipëri. Pjesa më e madhe e vajzave dhe grave, që janë pre e dhunës, vuajnë në heshtje dhe nuk arrijnë dot ta denoncojnë dhe të shkëputen nga cikli i saj. Dhuna me bazë gjinore është një fenomen që nën raportohet në vendin tonë, si dhe në pjesën më të madhe të rasteve të dhunës viktimat mbeten skeptike ndaj ndihmës që mund të marrin pasi raportojnë.

Në vitin 2020, nga 52 vrasje me dashje rreth 13.5 % e tyre kanë ardhur si rezultat i vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare. Gjatë vitit

³ INSTAT. (2019). Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën 2018. Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri.

⁴ OSCE. (2019). Anketë e Udhëhequr nga OSBE Për Dhunën ndaj Grave në Shqipëri. Mirëqenia dhe Siguria e Grave.

⁵ INSTAT. (2021). Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. <https://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

2020, në polici janë raportuar 3.333 gra për dhunë në familje. Këto shifra të dhunës në familje pasqyrojnë vetëm numrin e raportimeve të bëra në polici (INSTAT, 2021, f.91).⁶ Po ashtu, studimi i ndërmarrë nga OSBE për Mirëqënien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri, evidenton se vetëm 3% e grave që kanë përjetuar dhunë nga partneri i tyre aktual në periudhën e studimit, kanë raportuar në polici incidentin më të rëndë të dhunës që i ka ndodhur.⁷

Dhuna në familje dhe në përgjithësi dhuna ndaj vajzave dhe grave vazhdon të jetë një dukuri shqetësuese në Shqipëri. Ajo mbetet kryesisht pas dyerve të mbyllura për shkak të mentalitetit që e sheh dhunën si një çështje private dhe familjare. Sigurisht, në heshtjen ndaj dhunës me bazë gjinore ndikojnë shumë faktorë shoqërorë si normat, kultura dhe mjedisi përreth tyre, por në anën tjetër dhe mungesa e besimit në institucionet e vendit si policia apo shërbimet sociale vendore mbetet një faktor përcaktues.

Shteti shqiptar ka një sërë detyrimesh që lidhen me përmbushjen dhe ruajtjen e standarteve të drejtave dhe mbrojtës së vajzave dhe grave që duhet të përmbushë në sajë të marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara. Këto detyrime mund të renditen si: detyrimi për të mbrojtur (detyrimi pozitiv) gratë dhe vajzat nëpërmjet krijimit të strehëzave për viktimat të dhunës në familje (gra, fëmijë, etj), sigurimin e shërbimeve shëndetësore për viktimat, mbështetja e shërbimeve sociale, si dhe ofrimi i trajnimeve për policinë për të adresuar dhunën në familje. Po ashtu, detyrimin për të përmbushur (detyrim pozitiv), që kërkon marrjen e masave të duhura për të siguruar realizimin e standardeve të të drejtave të grave në ofrimin e shërbimeve dhe garantimin e aksesit për viktimat e dhunës.⁸

⁶ INSTAT. (2021). Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021. <http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

⁷ OSCE. (2019). Anketë e Udhëhequr nga OSBE Për Dhunën ndaj Grave në Shqipëri. Mirëqenia dhe Siguria e Grave.

⁸ Mandro.I & Agastra.F. (2008). Dhuna në Familje. Përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj. UNDP & Japan WID Fund Support.

Dhuna me bazë gjinore tek të rinjtë

Një përqindje shumë e lartë e të rinjve 88% pohojnë se dhuna ndaj vajzave dhe grave është e përhapur dhe një fenomen shqetësues. Në të njëjtën linjë, një pjesë e madhe e të rinjve mendojnë se dhuna seksuale ndaj grave në Shqipëri është e përhapur (80%), nga partnerët ose nga njerëz në rrethin e besimit apo të panjohur. Më tej, raporti tregon se thuhet se 1 në 10 vajza është detyruar që të kryejë marrëdhënie seksuale për herë të parë kundër dëshirës së saj. Po ashtu, raporti Rrjetit të Fuqizimit në Grave në Shqipëri (AWEN) tregon se vajzat kanë pothuajse tre herë më shumë probabilitet që të detyrohen të kryejnë marrëdhënie seksuale nga frika e partnerit/ish – partnerit (Dhëmbo E., Duci V., 2020).

Të dhëna edhe më shqetësuese nga raportojnë se 2 në 3 të rinj nuk kanë kërkuar asnjë ndihmë për dhunën e përjetuar, qoftë fizike, qoftë seksuale, për shkak të mungesës së besimit tek institucionet e ndryshme (policia dhe shërbime të tjera), ndjenjës së turp-it dhe druajtjes, si dhe frikës nga prishja e reputacionit të familjes, shkruhet në raport. “Pengesë në raport me identifikimin/raportimin e dhunës me bazë gjinore është edhe niveli i informimit. Një në katër të rinj nuk e kishte idenë (8%) apo nuk ndihej i informuar mjaftueshëm (18%) për të ditur se si duhet të reagojë në situata dhune”, - citohet në studimin e Rrjetit të Fuqizimit në Grave në Shqipëri (AWEN). Për më tepër, rreth 35% e të rinjve apo një në tre të rinj nuk e shohin si alternativë të përshtatshme raportimin e dhunës në familje tek një oficer/e policie.⁹

⁹ Dhëmbo E., Duci V., Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.

Raportimi i ulët i dhunës me bazë gjinore dhe mungesa e besimit në institucionet përkatëse

Në Shqipëri, vajzat dhe gratë e kanë të vështirë për të raportuar dhunën që mund të ushtrohet ndaj tyre duke pasur ndrojtje nga paragjykimet, traditat dhe zakonet patriarkale, rolet e ngurta gjinore, turpi, faji apo stigmatizimi. Këto pengesa me të cilat përballen, duket të jenë një anë e problemit, por në anën tjetër, mungesa e besimit në institucionet publike, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë apo shërbimet sociale, dekurajojnë viktimat/të mbijetuarat të kërkojnë ndihmë apo të raportojnë dhunën.

Normat dhe qëndrimet kulturore në Shqipëri favorizojnë nënshtrimin e grave ndaj dhunës dhe pranimin e saj në një shkallë të lartë. Ky fakt mund të shpjegohet me bindjen e 48% të grave se dhuna në familje është “një çështje private” që duhet të mbahet brenda familjes dhe sigurisht që të tilla perceptime nxisin një mjedis që toleron dhunën ndaj grave (OSCE, 2019).¹⁰ Por, në anën tjetër, duket se stigma dhe neglizhimi i dhunës kundrejt grave dhe vajzave që raportojnë dhunën gjendet rëndom në institucionet e vijës së pare si organet e rendit apo shërbimet sociale, e kjo është shkak që shumë prej viktimave të mos raportojnë asnjëherë dhe të vuajnë në heshtje pasojat e këtij krimi.

Shumica e viktimave në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë në heshtje, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të ndërgjegjësuar njerëzit rreth dhunës me bazë gjinore dhe ligjeve të reja për dhunën dhe shërbimet e mbështetjes së viktimave. Shqetësues është fakti që gratë dhe vajzat vijojnë të vuajnë pasojat e dhunës me bazë gjinore në heshtje dhe nuk kërkojnë shërbime mbështetëse që sigurojnë qasje në drejtësi (INSTAT, 2019, f.102).

¹⁰ OSCE. (2019). ANKETË E UDHËHEQUR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI. MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE.

Në Vrojtimin Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave rezultoi që vetëm 16.9% e vajzave dhe grave që përjetonin "aktualisht" dhunë në familje i kishin treguar dikujt për dhunën dhe vetëm 8.4% kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje. Vetëm 30.8% e grave që përjetonin "aktualisht" dhunë fizike dhe/ose seksuale ose të dyja, kishin gjasa t'i tregonin dikujt për dhunën dhe vetëm 18.5% të kërkonin ndihmë (INSTAT, 2019, f.102). Të dhëna të tjera shqetësuese nga vrojtimi treguan që shumë pak gra kërkojnë ndihmë nga burime zyrtare, si shërbimet mbështetëse për viktimat të ofruara nga agjencitë, sistemi shëndetësor, policia dhe/ose sistemi i drejtësisë (INSTAT, 2019, f. 132). Të dhënat e disponueshme nga vrojtimi treguan që më pak gra kishin kërkuar ndihmë nga rrjete zyrtare si policia, mjekët/punonjësit e shëndetësisë, agjenci/organizatë e shërbimit social apo dhe strehëzat për gratë dhe vajzat. Për më tepër, asnjë grua nuk kishte kërkuar ndihmë nga linja telefonike 24 orëshe pa pagesë dhe/ose nga koordinatori lokal për dhunën në familje. (INSTAT, 2019, f.131). Këto gjetje mund të bëjnë të mendojmë se, ose gratë nuk kanë dijeni për linjën telefonike pa pagesë dhe/ose për koordinatorët lokalë për dhunën në familje, ose të mbijetuarat e dhunës në familje nuk kanë besim në këto rrjete formale të shërbimeve mbështetëse

Dhuna me bazë gjinore ndaj vajzave të reja dhe grave gjerësisht pranohet si një normë shoqërore, si rrjedhojë shpeshherë trajtohet në mënyre indiferente nga institucionet e vendit. Duket se shkaqet rrënjësore të manifestimit të dhunës me bazë gjinore shpeshherë qëndrojnë në mendësinë dhe praktikën e institucioneve dhe punonjësve të këtyre institucioneve kundrejt dhunës në përgjithësi dhe në veçanti të asaj me bazë gjinore.

Në të njëjtën linjë, studimi i ndërmarrë nga OSBE (2019) për Mirëqënien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri, tregoi se gratë dhe vajzat nuk parapëlqejnë t'u drejtohen institucioneve në rastet kur pësojnë dhunë.

“Edhe pas incidenteve më serioze të dhunës fizike dhe/ose seksuale, 97% e grave që ishin dhunuar nga partneri aktual nuk e kishin raportuar incidentin në polici dhe kjo vllente edhe për 84% të rasteve të dhunës serioze nga partnerët e mëparshëm”, - evidentohet në studim.¹¹ Gjetjet e studimit evidentojnë se ndonëse se një në pesë gra pohojnë se kanë qenë objekt i dhunës fizike dhe/ose seksuale, shumica e tyre nuk e raportojnë dhunën në polici apo në institucione/organizata të tjera. Turpi, frika nga dhunuesi, mungesa e besimit të institucionet dhe mungesa e mbështetjes pengojnë raportimin (OSCE, 2019).¹² Duket se vajzat dhe gratë nuk e shohin raportimin si një formë për të shpëtuar dhunës, përtej kësaj, ekziston frika nga ajo që mund të ndodhte po qe se partneri informohej për raportimin si dhe mungesa e besimit tek institucione të tilla si policia. Një tjetër gjetje e këtij studimi ishte perceptimi që gratë rreme që morën pjesë në studimin cilësor, mendonin se do të injoroheshin nga policia nëse do raportonin dhunën e shkaktuar nga partneri intim (OSCE, fq 49).

¹¹ OSCE. (2019). ANKETË E UDHËHEQUR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI. MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE.

¹² OSCE. (2019). ANKETË E UDHËHEQUR NGA OSBE PËR DHUNËN NDAJ GRAVE NË SHQIPËRI. MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE.

Konkluzione dhe Rekomandime - Mekanizmat e identifikimit të dhunës me bazë gjinore

- Një pjesë e mirë e grave, që janë subjekt i dhunës, vuajnë në heshtje dhe nuk arrijnë dot ta denoncojnë dhe të shkëputen nga cikli i saj. Faktet tregojnë se besimi dhe perceptimi mbi institucionet e rendit mbetet i ulët dhe reflekton dështimin e vazhdueshëm të institucioneve për të qenë ndër zgjedhjet e viktimave/të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore për të raportuar dhunën.
- Problem mbetet qasja e institucioneve dhe nevoja për përmirësimin e qasjes së tyre. Policia, e cila luan rolin kyç në mbrojtjen e viktimave, duhet të jetë më e përfshirë dhe të zhvillojë një qasje më empatike në momentin që viktimat shkojnë në dyert e policisë për të raportuar rastin e tyre. Siç evidentohet dhe nga situata faktike, roli i Policisë shihet me skepticizëm dhe ka një mungesë të theksuar të besimit në organet e rendit.
- Një pjesë e vogël e rasteve të abuzimit ndaj vajzave janë bërë publike për opinionin publik, ku shpeshherë vihet re apatia dhe mungesa e seriozitetit që karakterizon institucionet e rendit dhe ato të shërbimeve sociale. Gjithashtu, strukturat e policisë, në një pjesë të rasteve vazhdojnë ta trajtojnë DHBGJ-në si çështje të sferës private, duke shmangur ndërhyrjen efektive të tyre në rastet e denoncuar dhe orientuar zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes mes anëtarëve të familjes (AP, 2020, fq.39).¹³

¹³ Avokati i Popullit. (2020). RAPORT ALTERNATIV MBI ZBATIMIN E KONVENTËS CEDAË NË SHQIPËRI 2016 – 2020.

- Përdorimi i policimit në komunitet si një mjet parandalues për përmirësimin e bashkëpunimit midis punonjësve të policisë dhe komunitetit është një mënyrë për rritjen e raportimit të dhunës me bazë gjinore. Prej vitesh në Shqipëri, Ministria e Brendshme jehon policimin në komunitet si një prej komponentëve të parandalimit të kriminalitetit dhe dhunës në përgjithësi. Përtej narrativës boshe, policimi në komunitet mbetet një dështim i organeve të rendit. Nuk ka shifra zyrtare, modele konkrete apo histori të sukseshme të funksionimit të Policimit në Komunitet. Është e rëndësishme të përmendim se në vitin 2017 Ministria e Brendshme firmosi marrëveshjen për projektin e financuar nga qeveria e Suedisë, për "Forcimin e Policimit në Komunitet, 2017-2020", ku pala suedeze ofroi 3.3 milionë euro mbështetje për policinë.
- Është i nevojshëm përmirësimi i funksionimit të Mekanizmave të Referimit për të qenë më efikas në identifikimin e hershëm të rasteve të dhunës dhe përgjigjen me efikasitet ndaj rasteve. Mbeten problematika kyçe zbatimi i dobët i legjislacionit përkatës për dhunën dhe mungesa e koordinimit nga disa "hallka" të anëtarëve të MKR-së dhe bashkëpunimi i dobët ndër-institucional.
- Parandalimi ka kosto më të ulët se ngjarjet tragjike që herë pas herë trondisin shoqërinë shqiptare, ndaj mbetet prioritet trajnimi i vazhdueshëm i profesionistëve të vijës së parë si: policët, koordinatorët lokal për dhunën, punonjësit socialë, profesionistët shëndetësorë për një rol më aktiv të tyre në identifikimin e rasteve dhe mekanizmat e referimit.
- Përtej zhvillimeve në legjislacionin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në nivel vendor, institucionet lokale kanë nevojë të përmirësojnë shpërndarjen e shërbimeve sociale, veçanërisht në

zona të largëta, të zgjerojnë tipologjinë e shërbimeve, llojshmërinë e tyre, të jenë në përshtatje me nevojat e viktimave. Ofrimi i shërbimeve themelore për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore mbetet një sfidë e madhe në Shqipëri.

Në shumë raste, në të gjithë vendin, të mbijetuarat e dhunës ende nuk kanë mundësi të marrin shërbimet më themelore për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Pjesa më e madhe e shërbimeve ofrohen vetëm në qytetet kryesore ku operojnë dhe pjesa më e madhe e organizatave jofitimprurëse. Në pjesën më të madhe të rasteve, janë ende organizatat joqeveritare që merren me rehabilitimin dhe ri/integrimin e të mbijetuarave të dhunës apo trafikimit, si dhe në të njëjtën kohë, përballen me mungesën e fondeve dhe personelit të mjaftueshëm.

- Niveli i ulët i rasteve të raportuara të dhunës vjen si rrjedhojë e dobësive në sistemin e identifikimit të hershëm dhe koordinimit të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Është e nevojshme analiza e shkaqeve dhe pasojave për mos-reagimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse në përputhje me rregullat dhe legjislacionin. Përgjegjësia mbi numrin e ulët të raportimeve duhet të jetë e të gjithë aktorëve si dhe duhet rritur ndjeshmëria e tyre në raport me fenomenin e dhunës me bazë gjinore.
- Është me rëndësi të nënvizohet se mos raportimi i rasteve të dhunës nga përjetuesit e dhunës apo dëshmitarët, ndikon në krijimin e një perceptimi ku, tek ushtruesi i dhunës po krijohet bindja se me të vërtetë dhuna është e pranueshme nga shoqëria dhe e padënueshme nga institucionet.

Referenca

Amnesty International. (2006). Shqipëria - Dhuna kundër grave në familje: "Nuk është turpi i saj".

Aksesuar për here të fundit më 08.05.2022:
<https://www.amnesty.org/en/documents/eur11/002/2006/sq/>

INSTAT. (2019). Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën 2018. Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri.

Aksesuar për here të fundit më 07.05.2022:
<http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>

UN Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women (CEDAW)

INSTAT. (2021). Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2021.

Aksesuar për here të fundit më 05.05.2022:
<http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

OSCE. (2019). Anketë e Udhëhequr nga OSBE Për Dhunën ndaj Grave në Shqipëri. Mirëqenia dhe Siguria e Grave.

Aksesuar për here të fundit më 06.05.2022:
<https://www.osce.org/files/f/documents/d/1/441832.pdf>

Dhëmbo E., Duci V., Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri, AWEN, 2021.

Aksesuar për here të fundit më 08.05.2022: https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2021/07/AWEN-Dhuna-AL-pages-web_compressed.pdf

Avokati i Popullit. (2020). Raport Alternativ Mbi Zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri 2016 – 2020.

Aksesuar për here të fundit më 05.05.2022:
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20alternative%20mb%20zbatimin%20e%20Konventes%20CEDAW%20ne%20Shqiperi.pdf>

Mandro.I & Agastra.F. (2008). Dhuna në Familje. Përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e saj. UNDP & Japan WID Fund Support.

Aksesuar për here të fundit më 06.05.2022:
http://www.undp.or.jp/undpandjapan/widfund/pdf/Albania_Manual%20for%20Policy%20Officers%20in%20Albania.pdf

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al